



1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

**Raporti për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Lejeve dhe Licencave në Autoritetin e
Hekurudhave të Kosovës**

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

GIZ - Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

LPPA - Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

LHK-Ligji Nr. 04/L-063 Për Hekurudhat e Kosovës

LSLL-Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

LPN- Ligji Nr.04/L-110 Për Ndërtimin

PVK – Pikat e Vetme të Kontaktit

RQLL-Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave

ZKM - Zyra e Kryeministrit

ZL - Zyra Ligjore

ARH – Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

1.Hyrje

Ky raport i mbështetur nga GIZ ka për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete, për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisjen me leje dhe licenca në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) si dhe të bëjë harmonizimin e lejeve dhe licencave të ARH me kërkesat dhe kriteret e LSSL. Thjeshtësimi i lejeve dhe licencave është vlerësuar në kuadër të disa primeve dhe kërkesave të cilat përcaktohen në LSSL si dhe në LPPA.

Në kuadër të këtij raporti është ndjekur metodologji e atillë, ku janë nxjerrë: **1.Rekomandime konkrete**, për lejet dhe licencat të cilat i aplikon ARH. Rekomandimet e veçanta janë të vendosura në shtojcën e këtij raporti dhe janë të dhëna për secilën leje ose licencë, në mënyrë të veçantë, sipas të gjeturave.

Po ashtu, përveç rekomandimeve në raport janë përshkruar edhe të gjeturat kryesore të cilat ndjekin qëllimin e raportit, për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave si dhe harmonizimin e tyre me LSSL.

Thjeshtëzimi i lejeve dhe licencave dhe harmonizimi i tyre në ARH, sipas këtij raporti, merr parasysh veçanërisht:

1. Lehtësimi i procedurës së aplikimit për leje dhe licenca;
2. Lehtësimi i barrës administrative të palës me rastin e aplikimit;
3. Lehtësimi i procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të provave/dëshmime;
4. Çështjen e sigurisë së bartësit të licencës, në kuptim të zgjatjes së afatit, bazuar në kriteret e specifikave të licencave ose lejeve, varësisht nga niveli i rrezikshmërisë;
5. Çështja e ligjshmërisë së licencave, dhe bazës specifike ligjore, në kuptimin që të njëjtat të jenë të parapara me ligj, sipas emërimit nga ARH, bazuar në regjistrin qendror të lejeve dhe licencave;
6. Çështjen e harmonizimit dhe përshtatshmërisë së kërkesave të LSSL me rregullimet e përcaktuara në Legjislacionin e aplikueshëm.

Për të hartuar këtë raport janë shqyrtuar disa burime dhe atë si në vijim: LSSL; LPPA; LHK; Ligjet; Aktet nënligjore të fushës që rregullojnë procedurën e pajisjes me leje dhe licenca. Po ashtu një rëndësi të veçantë e kanë pasur edhe takimet me institucionet relevante të cilat kanë shërbyer për sqarime shtesë.

Për efekte të këtij raporti është përdorur terminologjia e emërimit “leje dhe licenca” sipas LSSL që përfshijnë edhe aplikimin e llojeve të tjera të lejimeve që lëshohen nga ARH dhe nuk emërtohen si leje dhe licenca.

2.Analiza ligjore përkitazi me thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave

Në këtë pjesë prezantohet analiza e legjislacionit kryesor që rregullon lejimet (lejet dhe licencat) në ARH. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (LSSL) është ligji horizontal që në nenin 1 rregullon parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Ligj tjetër horizontal që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik ku më së shpeshti vjen në shprehje tek lejimet është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), qëllimi i të cilit është

të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë në nenin 1 edhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.

Më poshtë do të analizojmë disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe rregullat si dhe kriteret e veçanta që përcaktohen me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 (LHK).

Sa më sipër, realizimi i qëllimit të raportit për lehtësimin e lejeve/autorizimeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ARH, kërkon një analizë të ligjeve të veçanta, siç është veçanërisht Ligji për Hekurudhat dhe aktet nënligjore që i referohen fushës në kuptim të lejeve dhe licencave të cilat i lejon, në veprimtaritë e caktuara. Përveç ligjit për Hekurudhat, sistemi i lejeve dhe licencave rregullohet, për aq sa është e nevojshme edhe me ligjet si: **Ligjin Nr. 04/L -110 për Ndërtimin**. Megjithatë këto ligje i referohen licencave dhe lejeve tjera që i lëshon ARH, vetëm në kuptimin e sqarimit të një personi juridik ose fizik të licencuar, pasi që sistemi i lejeve dhe licencave, procedura, mënyra e dhënies së tyre, kriteret etj, rregullohen me ligjin për Hekurudhat dhe aktet nënligjore e nxjerra nga ARH dhe, ministria e linjës, ku ndër të tjera janë:

Rregullore Nr.03/2020 për Licencim;

Rregullore Nr.02/2013 per Licencimet e Makinistëve;

Rregullore Nr.01/2020 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores 02/2013 per Licencimet e Makinistve;

Udhëzimi Administrativ 02/2012 per Licencimet e Operatoreve të Transportit Hekurudhor;

Udhëzimi Administrativ Nr.17/2017 per Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 02/2012 per Licencimin e Transportit Hekurudhor;

Udhëzimi Administrativ Nr.03/2012 per Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhore;

Udhëzimi Administrativ Nr.18/2017 per Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhore;

Rregullorja Nr. 02/2012 për Certificate të Sigurisë;

Rregullorja Nr. 03/2012 për Autorizim të Sigurisë;

Rregullorja Nr. 03/2018 për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizim për Vendosje në shërbim të Mjetit Lëvizës;

Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 Për Dhënien e Certificate se Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore;

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 Për Ndryshimin/Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2012 Dhënien e Certificate se Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore;

Rregullorja Nr.04/2017 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë, për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë Hekurudhore;

Rregullorja Nr.02/2018 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Certificate të Sigurisë Hekurudhore;

Rregullorja Nr.06/2018 për përdorimin e një formati të përbashkët Evropian për Çertifikaten e Sigurisë, Dokumentat e Aplikimit dhe Vlefshmëria e Çertifikatës së Sigurisë;

Rregullorja Nr.02/2020 për Taksa dhe Gjoha për plotësim/ndryshimin e Rregullores nr.01/2017.

Në kuptim të emërimit, LSLL në nenin 1 (1.3) përdor termin **“I licencuari – personi fizik të cilin i është lëshuar një licencë profesionale”**, në anën tjetër **Ligji Nr. 04/L – 063 për Hekurudhat e Kosovës**, nuk saktëson shprehimisht termin i licencuar, por i referohet “ndërmarrja hekurudhore e licencuar”. Megjithatë, sa i përket lejeve, ligji përkatës në nenin 3 (1.6) përcakton termin “Licenca Hekurudhore” me të cilin kuptohet dokumenti i cili zyrtarisht njeh aftësinë e ndërmarrjes për të kryer shërbimet e transportit me hekurudhë të përmendura në këtë dokument.

Përderisa LSLL në nenin 5 ka përcaktuar llojet e lejimeve, siç janë: *njoftimi, regjistrimi, leja dhe licenca profesionale*, në anën tjetër ARH njeh dhe aplikon tri lloje të lejeve dhe licencave që emërtohen: *licencë, autorizim dhe certifikim*. Licencat të cilat lëshohen janë: Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës Hekurudhore, Licencimin e Operatorëve Hekurudhorë (transport të udhëtarëve dhe mallrave), Licencimin e Makinistëve të Trenit, si dhe Amandementimin, Suspendimin dhe Revokimin e licencave të lëshuara për kategoritë e lartcekura. Në kuadër të sistemit të lejeve dhe licencave të cilat lëshohen nga ARH, bazuar në ligjin e Hekurudhave, çështja e lehtësimit të lejeve dhe licencave në këtë sektor siç u tha do të shikohet bazuar në disa parime, të cilat njihen nga LSLL dhe LPPA. Këto parime kanë për qëllim të arrijnë në rekomandime konkrete, për të bërë lehtësimin e lejeve dhe licencave të ARH si dhe harmonizimin e tyre me kërkesat dhe kriteret e LSLL.

Mos diskriminimi. Ky parim përcaktohet në nenin 6 të LPPA dhe si i tillë duhet të aplikohet edhe nga ARH, në raport me vendosjen për licencat dhe lejet e tjera që i bën. Veçanërisht ky parim përcaktohet në mënyrë strikte kur bëhet fjale tek kohëzgjatja e licencës, të cilën ARH (përkatësisht Organi i Licencimeve Hekurudhore) e vlerëson dhe e vendos duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga legjislacioni. Në rastin konkret, neni 22 i Ligjit të Hekurudhave përcakton që *“Organi Licencues duhet të ketë për detyrë që të rishikon validitetin e licencave në baza të rregullta së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se ndërmarrja hekurudhore i plotëson obligimet e përcaktuara me ligj”*. Në lidhje me këtë edhe neni 93 (2) përcakton që *“organi licencues mund të ofrojë shqyrtim të rregullt të paktën çdo pesë (5) vite”*. Për më tepër në Rregulloren Nr.03/2020 Për Licencim, në nenin 7 (Kohëzgjatja e Licencës) lëshuar nga ARH saktësohet që *“Licencat nuk kanë afat të caktuar, mirëpo të njëjtat janë të vlefshme deri sa të gjitha kushtet për marrjen e licencës vazhdojnë të përmbushen nga mbajtësi i saj”*.

Duhet theksuar se në ligjin bazik (Ligji i Hekurudhave), përkatësisht neni 1 përcakton që qëllimi i ligjit është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor. Po ashtu në nenin 10 specifikohet që ARH duhet të siguroj që procesi i vendimmarrjes për dhënien e licencave të jetë i drejt, transparent dhe jo diskriminues dhe që vendimet t’i nënshtrohen shqyrtimit ligjor, sikurse dispozita tjetër (neni 19) që flet rreth asaj që Organi për Sigurinë Hekurudhore duhet të kryej detyrat e veta në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Tutje në nenin 25 përcaktohet që ARH vepron si organ për ankesa për tregun hekurudhor, nga dhe secili aplikant duhet të ketë të drejtë të ankohet nëse beson që ka qenë i trajtuar në mënyrë të padrejtë, i diskriminuar dhe në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga menaxheri i infrastrukturës, operatori i pajisjeve edhe për ofrimin e shërbimeve apo kur është e mundur edhe nga ndërmarrja hekurudhore.

E Drejta e ankesës. Kjo përbën një obligim kushtetues. Sistemi i shqyrtimit të licencave në ARH si dhe procedurat për këtë parashohin të drejtën e ankesës në rast të refuzimit. Kësisoj, neni 23 (5) përcakton që vendimet e Organit licencues mund t’i nënshtrohen shqyrtimit ligjor pranë gjykatës kompetente nëse ndaj tyre përdoren mjete juridike. Edhe neni 19 (8) përcakton që të gjithë personat e involvuar dhe palët e

interesuara, duke përfshirë menaxherët e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e mirëmbajtjes, shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e stafit, kanë të drejtë të iniciojnë dhe deponojnë ankesa dhe të iniciojnë procedura gjyqësore në pajtueshmëri me procedurat e parapara kundrejt Organit Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore, ndërsa në kuadër të nenit 116, par.7 (Nënsistemet hekurudhore në Kosovë dhe futja e tyre në shërbim) theksohet që Entiteti legal i cili dëshiron t'i fus në shërbim dhe operim nënsistemet strukturale në Kosovë, e ka të drejtën e ankesës te ARH nëse ndihet se i është ndaluar, kufizuar apo prapësuar ndërtimi, futja në shërbim dhe operim e sistemeve nën strukturale. Po ashtu Neni 92 (par.24) i Ligjit për Hekurudhat përcakton që *“vendimet e organit licencues mund të nënshtrohen shqyrtimit ligjor”* por pa u ndaluar tutje në trajtimin apo shtjellimin e dispozitës përkatëse në lidhje me procedurën (aspektin procedural), se kur mund të ushtrohet ankesa, ndaj kujt, dhe/apo se cili organ e shqyrton, fazat apo hapat që duhet të ndjekën etj. Andaj, ARH duhet të shikojë mundësinë që të përcaktojë me rregullore një procedurë të ankesës për mos licencim. E drejta për refuzimin e licencës ose lejimit përcaktohet edhe me LSSL, respektivisht nenin 27.

Pagesa e taksave. LSSL përcakton një taksë proporcionale, për atë që ajo është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Në anën tjetër, LPPA përcakton mos pagesën e procedurës dhe sipas kësaj kjo pagesë mund të bëhet vetëm në raste kur përcaktohet ndryshëm me ligj. Në rastin e ARH, Neni 39 (par.16) i ligjit për Hekurudhat përcakton se ARH do të krijojë të hyra duke përfshirë mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në të hyra nga taksat për aplikacione për licenca, leje speciale, licenca tjera. Sipas Rregullores Nr. 02/2020 për plotësim ndryshimin e rregullores Nr.01/2017 për Taksa dhe Gjoha, sa i përket taksave në lidhje me aplikimin për licenca, autorizim, certifikim dhe autorizim për futje në shërbim aplikohet në dy faza, taksa për aplikim (fazën fillestare) dhe taksa për marrje të Autorizimit/Licencës/Certifikatës/Autorizimit për futje në shërbim .

Parimi i një sporteli të vetëm (pikat e vetme të kontaktit), është obligim ligjor i përcaktuar si në LSSL, respektivisht nenin 16 ashtu edhe në LPPA si dhe LPPA nenin 33. Sipas këtij parimi të gjitha formalitetet dhe procedurat për lëshimin e një leje dhe licence duhet të kryhen përmes PKV të kontaktit. Të dyja ligjet lejnë hapësirë që PKV të krijohen në mënyrë fizike, elektronike apo të kombinuara. Parakusht kryesor për t'i krijuar PKV janë pikat që i cekën më lartë, sidomos qasja e orientuar nga parimi i shqyrtimit administrativ sipas detyrës zyrtare. Nga ajo çka kemi hulumtuar dhe konfirmuar nga ARH ekziston një zyre e pranimit dhe e arkives si lloj tipi i PKV në mënyrë që të ju ndihmojë palëve në kryerjen e procedurave. Rregullorja Nr.03/2020 për Licencim, neni 8 përcakton që *“për aplikimin për licencë duhet të përdoret formular zyrtar i aplikimit që mund të merret në ueb faqe ose në zyrat e ARH-së, por pa e specifikuar një PKV që në mënyrë ekskluzive merret vetëm me këtë çështje.*

Parimi i aplikimit të ndihmës administrative. Neni 34 i LPPA përcakton se organi publik mund të kërkojë ndihmë nga një organ tjetër publik, ndër të tjera për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër. Ky parim mund të përdoret për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme. ARH në rastin e shqyrtimit të procedurës së lejeve dhe licencave aplikon parimin e ndihmës administrative,

Nga analiza si dhe sqarimet e dhëna vërejmë që formularët e aplikimit për licencë të Menaxherit të Infrastrukturës për Operator Hekurudhore dhe Licencë Makinisti janë të publikuara në ueb sajtin (faqen) e ARH dhe palët në momentin e aplikimit duhet ti përdorin këto formular, ndërsa si PKV është zyra e pranimit apo arkiva (siç u specifikua më lartë) e cila pranon dokumentacionin dhe më pas e përcjell tek departamenti përkatës. Pra, nga të dhënat/sqarimet respektive, vërejmë që ARH ani që nuk e saktëson shprehimisht ndihmën administrative, prap se prap nuk e kufizon mundësinë e aplikimit të kësaj ndihme (administrative) përkundrazi e aplikon drejtpërdrejtë.

Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Këtë parim e lejon neni 86 i LPPA. Në fakt ky parim në dritën e lehtësimit të procedurave për dhënin e licencave në ARH, bazuar në mënyrën se si rregullohet procedura e licencimit në ARH duhet të kombinohet me parimin e aplikimit të ndihmës administrative. ARH nuk aplikon parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Në aspektin legjislativ pjesa që

i referohet “aplikacioni” bazuar në Rregulloren për Licencimin Nr. 03/2020 (neni 8) thekson që: Për ta trajtuar një aplikacion në afatin e duhur kohor, i njëjti duhet të jetë i kompletuar, dhe në momentin që aplikacioni kompletohet, brenda tre (3) muajsh ARH do të marrë vendim lidhur me kërkesën për licencë. Po ashtu në nenin 8 (3) përcakton që dhënia e informatave të pasakta ose fshehja e tyre, mund të rezultojë në refuzimin e aplikacionit.

Pra nga leximi (interpretimi) i dispozitës përkatëse, lenë të kuptohet që palët duhet të interesohen në lidhje me plotësimin (kompletimin) e dokumentacionit në afatin e caktuar. Megjithatë në takimet/komunikimet me përgjegjësit e këtij institucioni konstatohet që ARH për secilin proces që kategorizohen si leje dhe licenca ka të hartuar rregulloret e vecanta në të cilat përcaktohen kushtet dhe kriteret për këto procese. Neni 86.3 i LPPA, në lidhje me këtë parim përcakton: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre”*. Kjo nënkupton që në disa raste, kur dokumentet dhe kushtet e dokumentacionit për një licencë, nuk përcaktohen me ligj, atëherë ARH në rastin konkret mund të kërkojë nga pala që vetëm të evidentojë që disa dokumente ekzistojnë dhe të njëjtat t’i verifikoj, nëse ato ekzistojnë në organet publike. Në lidhje me këtë aspekt, nga komunikimi dhe adresimi i komenteve nga përfaqësuesit e ARH është konstatuar se si rregull në momentin që dokumentacioni për licencat nuk sillet i kompletuar nga pala në afatin e caktuar, siç e përcakton legjislacioni në fuqi, atëherë ato refuzohen.

E Drejta për të ofruar mendime, shpjegime dhe prova: Neni 94 i LPPA i lejon palës që përgjatë shqyrtimit dhe zhvillimit të procedurës të ofrojë prova dhe të sqarojë çështjet deri në vendosjen përfundimtare. Në rastin e ARH në momentin e aplikimit për licencë, vëren se pala nuk i ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, sipas detyrës zyrtare kërkon nga pala që të kompletë dokumentacionin dhe deri në momentin e përmbushjes së kompletuar apo të arsyetuar të dokumentacionit nuk e refuzon ad hoc aplikacionin. Përgjithësisht kur këto nuk dorëzohen deri në afatin final, atëherë ato refuzohen Megjithatë, në konsideratën tonë duhet të reflektohet në plotësim ndryshimin e rregullores për licencimin ARH/Nr. 03/2020 edhe nga fusha përkatëse.

Zhvillimi i procedurës së shqyrtimit në mënyrë elektronike. Neni 14.2. i LSSL përcakton: *“Çdo autoritet kompetent duhet ta bëjë të mundur për një person që aplikacionin për lejim ta bëjë në mënyrë elektronike”*. Kjo krijon mundësinë që në bazë të akteve të brendshme që nxjerr ARH për licencimin të mundësojë zhvillimin e një procedure të shqyrtimit në mënyrë elektronike. Kjo është e mundur pasi që nenin 17.2 i LSSL lejon që procedurat e aplikimit të licencës të bëhen me akt nënligjor. Megjithatë, e domosdoshme në këtë drejtim do ishte krijimi i bazës konkrete ligjore në Ligjin për Hekurudhat.

Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave. ARH përbën një rast të operimit me kushte të licencave dhe lejimeve tjera të natyrave specifike. Neni 92 i Ligjit për Hekurudhat përcakton kushtet për licenca nga ARH. Kushtet specifike që përcaktohen në nenin 92 si dhe nenin 96 (për licencimin e makinistëve), janë përcaktuar gjithashtu me rregulloren për licencimin Nr. 03/2020, si dhe në Rregulloren nr.02/2013 për Licencim të Makinistëve. Në rastin e ARH, dokumentet e nevojshme për një licencë kryesisht kanë të bëjnë me: *reputacionin e mirë, përshtatshmërinë financiare, të kenë kompetencë profesionale nga fusha e sigurisë, dhe të jetë i mbuluar me sigurim adekuat*. Duke marrë parasysh specifikat e licencave të ARH, atëherë në disa raste edhe dokumentacioni është specifik. Andaj, në bazë të analizës, reduktimi i dokumentacionit është kërkuar rast pas rasti, bazuar në dy alternativa: 1.Verifikimi i disa fakteve përmes deklaratës nën betim dhe 2. Identifikimi nga pala e disa dokumenteve si dhe veprimi i ARH, sipas parimit të ndihmës administrative dhe zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare që përcaktohen në LPPA.

3.Analiza ligjore përkitazi me harmonizimin e lejeve dhe licencave me kriteret e LSSL

Harmonizimi nën dritën e qëllimit të këtij raporti, nënkupton një proces të përshtatshmërisë së LSSL në rastin konkret dhe Ligjit për Hekurudhat, me qëllim të përcaktimit të lejeve dhe licencave që lëshon ARH, bazuar LSSL. Lidhur me aspektin e harmonizimit janë me rëndësi të evidentojmë çështjet si në vijim:

Përcaktimi i lejeve dhe licencave me ligj. Ky parim përcaktohet në nenin 17.1 të LSSL dhe si i tillë nënkupton që leja dhe licenca, qoftë edhe në kuptimin e emërimit të përcaktohet me ligj. Në rastin e ARH, ligji për hekurudhat kryesisht ndjek një logjik të tillë, duke specifikuar llojet e lejeve dhe licencave. Neni 92 (2) i Ligjit për Hekurudhat saktëson që *“Licenca duhet të specifikoj llojet e shërbimeve hekurudhore për të cilat pronarit i është dhënë licenca”*. Në linjë me këtë ligji bazik si dhe rregullorja për licencim (referuar më lartë), përcakton që ARH lëshon licencat për: menaxhim të infrastrukturës, transport hekurudhor të udhëtarëve, transport hekurudhor të mallrave dhe licenca të reja për makinist. Në lidhje me licencimin e makinistëve, ekziston rregullore e veçantë.

Emërtimet e lejeve dhe licencave të përcaktohen me ligj: Kjo kërkon që të gjitha lejet dhe licencat që lëshon ARH, si: licenca, autorizime dhe certifikime të përcaktohen me ligjin për Hekurudhat, sipas emërtimeve aktuale që i kanë, për çka dhe në ligjin bazik janë të përcaktuara dhe në përputhje me LSSL.

Krijimi i lejeve dhe licencave të ARH sipas nenit 5 të LSSL: Neni 5 i LSSL përcakton llojet e lejimeve të cilat janë: njoftim, regjistrim, leje dhe licenca profesionale. Në këtë rast edhe emërtimet e lejimeve që i bën ARH i përshtaten kësaj fryme, të cilat janë përcaktuar në nenet 46, 92 dhe 95 të cilat në masë të madhe janë të harmonizuara me nenin 5 të LSSL.

Kategorizimi i lejeve dhe licencave sipas rrezikut: ARHka përcaktuar një sistem të kategorizimit të lejeve dhe licencave, sipas rrezikut, sikurse e përcakton edhe neni 19 i LSSL. Në lidhje me këtë aspekt, ligji për hekurudhat respektivisht neni 94 tek pjesa “Certifikata e Sigurisë” flet edhe për pjesën e rrezikut.

Ajo çka duhet potencuar, është fakti se tek të gjitha lejet/certifikatat e lëshuara nga AHR si në pjesën e ligjit bazik e në veçanti tek legjislacioni sekondar (rregulloret/udhëzimet), është aplikuar/praktikuar transpozimi i direktivave të BE-së në sektorët përgjegjës.

4. Të gjeturat

1. Ligji për LSSL të “të licencuarit” i referohet vetëm personit fizik, kurse Ligji për hekurudhat me “të licencuar” nënkuptojnë edhe ndërmarrjet hekurudhore si persona juridik dhe menaxherët e infrastrukturës, përderisa tek kategoria tjetër tjera që lëshohen licencat në prizmin individual i njeh po ashtu me termin Licencë, p.sh. si Licencë e makinistit.
2. Në parim licencat e ARH nuk janë me afat të caktuar, mirëpo të njëjtat janë të vlefshme deri sa mbajtësi i saj vazhdojnë të përmbushen nga mbajtësi i saj, dhe/apo organi licencues mund të ofrojë shqyrtim të rregullt të paktën çdo pesë (5) vite, ndërsa Licencat për Makinistë të trenit janë me afat prej 10 viteve.
3. Në prizmin legjislativ përcaktohet një procedurë e ankesës për mos licencim në ARH.
4. Përkitazi me aplikimin për licenca dhe lejime të tjera, ekziston zyra e pranimit në ARH si dhe informatat relevante në ueb sajtin e ARH.
5. Në praktik zbatohet parimi i ndihmës administrative për të lehtësuar procedurën e verifikimit të dokumenteve të nevojshme që dorëzohen për licencë.
6. Zbatohet parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, për verifikimin e dokumenteve të identifikuar nga palët, që i posedojnë institucionet publike.
7. Sado që tek pjesa e aplikimit (në ueb të ARH) tek disa prej licencave, theksohet se pala mund të sjellë dokumentacionin shtesë, deri sa të vendoset në versionin final për aplikimin, në konsideratën tonë duhet të reflektohet në legjislacionin sekondar, respektivisht në Rregulloren nr.03/2020.
8. Nuk përcaktohet procedura elektronike si rregull.
9. Numër i dokumenteve që kërkohen tek kategoria e kërkesave të përgjithshme, nuk duket që shtonë barrën administrative për mënyrën se si kërkohen.

10. Në ARH ka leje dhe licenca që nuk përcaktohen shprehimisht me ligj, sipas emërimit të tyre aktual, por që i përgjigjet natyrave të aktit. (Shembull Licenca e parë në renditje tek Shtojcat).

5.Rekomandimet kryesore

1. Të rregullohet më specifikisht, se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik);
2. Ani që ekziston zyra e pranimi dhe informatat e mjaftueshme në faqen e ARH, konsiderojmë që në përputhje të plotë me parimet e LSSL, të krijohet një PKV në ARH vetëm për leje/licenca;
3. Të zhvillohet procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike;
4. Në rrafshin praktik palës i mundësohet që të ofrojë dëshmi shtesë deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licenca, autorizime, andaj kjo çështje të harmonizohet edhe në prizmin ligjor me parimet e LSSL;
5. Të verifikohen disa dokumente të nevojshme sipas deklaratës nën betim;
6. Të bëhet harmonizimi LHK dhe LSSL, sipas parimeve të përcaktuara.
7. Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA.

6. Arsyeimi i rekomandimeve kryesore

Të rregullohet në mënyrë specifike se kush mund të aplikojë për licencë dhe për cilat licenca (person fizik ose juridik). Ky rekomandim është dhënë për arsye se në Ligjin për hekurudhat nuk përcaktohet statusi të licencuarit, pra në kuptimin se a do të jetë person fizik ose juridik. Ligji Për hekurudhat, siç edhe u vë re, flet vetëm për licenca, sikurse në rastin kur trajtohet për persona juridik që në konsideratën tonë i referohet ndërmarrjes hekurudhore, e cila është përcaktuar në nenin 3 (1.1) si dhe menaxheri i infrastrukturës hekurudhore, reflektuar në nenin 3 (1.4) ndërsa për licencat (certifikatat) e makinistëve si persona fizik, e cila është referuar tek neni 95. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 17.2 të LSSL, ARH duhet ta vlerësojë që të përcaktojë qartësisht se cilat lejime, leje dhe licenca mund ti lëshojë për persona fizik e cilat për persona juridik, me qëllim që të bëhet harmonizimi me LSSL.

Baza e qartë ligjore për licencat ekzistuese të ARH. Bazuar në nenin 17.2 të LSSL lejet dhe licencat përcaktohen vetëm me ligj. Në rastin konkret të ARH ekziston baza e qartë ligjore për të gjitha veprimtaritë që duhet të kenë licencë.

Të përcaktohet procedura e ankesës për rast të mos licencimit. Në kuadër të ligjit si dhe rregullave që zbatohen të cilat vlejnë për procedurën e dhënies së lejimeve në kuadër të ARH, kanë përcaktuar një afat ankese për çështjen e refuzimit të licencimit ose vazhdimi të licencës. Për të respektuar të drejtat e palës duhet të krijohet një mekanizëm i ankesës, sipas parimeve të përcaktuara në LPPA dhe kjo mund të bëhet përmes rregullave që i miraton ARH. Nga hulumtimi dhe konfirmimi i zyrtarëve përgjegjës, parimisht me rastin e lëshimit të vendimit nga ARH, vendoset këshilla juridike për palën e pakënaqur dhe afatin për të paraqitur ankesën sipas normativës së përcaktuar nga LPPA.

Të krijohet një PKV në ARH.Një sportel i vetëm apo pikë e vetme e kontaktit duhet të krijohet në ARH, përse i takon procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit të licencave dhe lejimeve tjera të ARH. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të lehtësojë procedurën dhe do të koncentrojë kapacitetet shqyrtuese në këtë pikë. Po ashtu një gjë e tillë do të ndihmojë aplikuesit që në mënyrë efikase të fillojnë dhe përfundojnë procedurën si dhe gjithashtu, kjo do t'i ndihmojë edhe organin që më lehtësisht të shqyrtoj aplikimin. PKV duhet të veprojë edhe me rastin e ndryshimit të licencës apo lejimit si dhe procedurat e tjera të ankesës në procedurë të shqyrtimit etj.

Të zhvillohet procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave dhe të mos jetë domosdoshmëri vetëm aplikimi në kopje fizike. Procedura elektronike e shqyrtimit të lejeve dhe

licencave lehtëson jashtëzakonisht shumë aplikimin dhe shqyrtimin e licencave dhe lejimeve në ARH. Me krijimin e pikave të vetme të kontaktit mund të krijohet edhe një databaza, ose formë e aplikimit elektronik. ARH duhet të aplikojë mundësinë që vetëm dokumentet që duhet domosdoshmërisht për verifikim të dërgohen nga pala si dokumente fizike ose origjinale. Procedura elektronike mund të caktohet me rregulla të brendshme të ARH.

Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike. ARH duhet të aplikojë parimin e ndihmës administrative, përgjatë zhvillimit të procedurës dhe këtë ta bëjë të kombinuar me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Përmes aplikimit të këtij parimi, ARH do të verifikojmë një numër të dëshmimeve, të cilat nevojiten që të dorëzohen nga pala me parashtrimin e kërkesës. Përmes aplikimit të këtyre parimeve, ARH do të shmang dorëzimin e disa dokumenteve, me rastin e aplikimit të palëve për leje dhe licenca.

Të bëhet ripërtërija e licencave sipas parimit ex officio. Me rastin e ripërtërirës së licencës, sidomos kur këtë e kërkon ARH, procedura e verifikimit të fillohet dhe të përfundohet duke respektuar veprimin e ndërmarrjes së procedurave sipas detyrës zyrtare. Ky parim do të vinte në shprehje edhe me rastin e ripërtërirës së licencës si dhe modifikimit të saj.

Të shqyrtohet mundësia që disa dokumente të nevojshme të verifikohen sipas deklaratës nën betim. Kjo për të lehtësuar edhe më shumë barrën administrative, ani që në rastin e ARH janë përgjithësisht të arsyeshme, shumica e kërkesave. Reduktimi i këtyre dokumenteve mund të bëhet në atë mënyrë që disa çështje që duhet të jenë pjesë e aplikacionit, të vërtetohen përmes deklaratës nën betim, duke pasur parasysh faktin që sipas ligjit për hekurudhat licenca mund të tërhiqet në rast se aplikuesi ofron të dhëna të pa vërteta.

T'i mundësohet palës që të ofrojë dëshmi e prova shtesë, përgjatë shqyrtimit të procedurës, deri në afatin e fundit të vendosjes. Në bazë të parimit të dëgjimit të palës, për të lehtësuar qasjen e aplikuesve, sipas praktikës së ndërtuar palës i jepet mundësia që deri në përfundimin e afatit të shqyrtimit të licencës, të sjell dokumentacionin plotësues. Kjo padyshim i ndihmon palës që të ketë qasje më të lehtë në aplikimin dhe shqyrtimin e licencës ose lejimit që lëshon ARH.

Të aplikohet afati 45 ditor i vendosjes për kërkesat për leje dhe licenca, sipas LPPA. Me qëllim të lehtësimit të procedurës dhe barrës administrative, ARH duhet të aplikojë afatin e vendosjes për kërkesën për leje dhe licencë, prej 45 ditësh, në pajtim me kërkesat e LPPA. Aplikimi i afatit 45 ditor do të zvogëloonte kohëzgjatjen e vendosjes dhe do të rriste efikasitetin si dhe lehtësonte barrën administrative të palës.

SHTOJCA

Në shtojcë janë përfshirë lejet dhe licencat e lëshuara nga ARH, sipas renditjes në RQLL

AUTORIZIMI I FUTJES NË SHËRBIM PËR LOKOMOTIVA, TRENA MOTORIK, VAGONË TË MALLRAVE DHE MJETEVE PËR MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS-MJETE LËVIZËSE HEKURUDHORE

1.Të gjeturat kryesore

1.1Baza ligjore për lëshimin e autorizimit:

Baza konkrete ligjore për autorizimin përkatës është dhënë në nenin 110 të Ligjit për Hekurudhat Ligji Nr. 04/L-063 (Autorizimi për vendosjen e mjeteve të transportit në shërbim). Përmes kësaj dispozite përcaktohet që mjetit të transportit për futje në shërbim duhet t'i jepet autorizimi nga organi përgjegjës për hekurudhore, kur të gjitha nënsistemet strukturale të mjetit të transportit kanë qenë të autorizuar për futje

në shërbim pas procedurave të vlerësimit dhe verifikimit të paraqitura në specifikimet teknike të interoperabilitet. Në këtë drejtim mjetit të konfirmuar të transportit i cili e ka autorizimin, duhet t'i jepet autorizimi për futje në shërbim duke u bazuar në deklaratën e konformitetit mbi tipin pa kontrollime të mëtutejshme.

Po ashtu ligji bazik përcakton që autorizimet për futjen e mjeteve të transportit në shërbim të lëshuar në Bashkimin Evropian dhe në shtetet tjera me të cilat Kosova ka marrëveshje të veçanta, duhet të konsiderohen si valide nëse janë pajtueshmëri me legjislacionin e Kosovës. Për sa i përket legjislacionit sekondar, referencë konkrete që e adreson çështjen përkatëse është Rregullorja nr. 03/2018 për ndërtim, përmirësim, rinovim, vlerësim të konformitetit dhe autorizimin për vendosjen në shërbim të mjetit lëvizës.

Në të njëjtën kohë, vendet të cilat kanë marrëveshje me Kosovën duhet ta njohin autorizimin për futje në shërbim të mjeteve të transportit të lëshuar nga organi përgjegjës për çështjet e sigurisë hekurudhore në Kosovë.

-1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet autorizimi:

Veprimtari për të cilën aplikohet është përdorimi i mjetit lëvizës në infrastrukturë hekurudhore.

1.3 Vlefshmëria kohore e Autorizimit:

Në parim autorizimet janë pa afat të caktuar.

1.4 Pagesa për pajisjen me autorizim:

Sipas Rregullores Nr. 02/2020 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2017 për Taksa dhe Gjoha aplikohet për taksat si në vijim: Taksa për Aplikim për mjetet lëvizëse hekurudhore të reja 150 euro, për mjetet lëvizëse hekurudhore 100 euro. Pagesa e taksës për autorizim aplikohet në atë mënyrë që për mjetet e reja lëvizëse 1 për qind nga vlera e blerjes së mjetit lëvizës, si dhe për mjetet e riparuar 1.5 për qind nga vlera e riparimit.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Dokumentacioni Teknik të mjetit lëvizës ku janë të përshkruara karakteristikat teknike siç janë: Lloji I transmetuesit të fuqisë, fuqia, pesha, ngarkesa boshtore, shpejtësia, forca tërheqëse, distanca boshtore, lartësia maksimale, gjerësia maksimale, lloji motorit, testet për riparimet e kryera, riparimet e kryera në 5 (pesë) vitet e fundit [Origjinal]
2. Kompania e cila e bën mirëmbajtjen duhet ta ketë mirëmbajtjen e certifikuar nga autoritetet e shtetit përkatës dhe bazuar në standardet Evropiane; [Kopje]
3. Testet e mjetit lëvizës
4. Certifikatat e kualitetit sipas ISO standardit dhe deklaratat e konformitetit, për të cilat kompania e cila e kryen riparimin është e certifikuar; [Origjinal]
5. Certifikatat e kualitetit sipas ISO standardit dhe deklaratat e konformitetit, për të cilat në kontraktorët (furnizuesit me pjesë) janë të certifikuar; [Origjinal]
6. Katalogut të pjesëve të ndërruara ti bashkëngjiten edhe Deklaratat e Konformitetit nga prodhuesi; [Kopje]
7. Dokumentacioni I testimit të mjetit lëvizës pas testimit - testimet e motorit, sistemit hidraulik, pneumatik, mekanik dhe elektrik (elektronik); [Kopje]
8. Të përshkruhen ndryshimet substanciale nëse ka; [Kopje]

9. Raporti I pranimit Teknik të mjetit lëvizës nga komisioni etj. [Kopje]

2.Rekomandimet

1. Disa dokumente të nevojshme për aplikim për këtë autorizim të vërtetohen sipas parimit të ndihmës së organeve administrative dhe veprimit ex officio ose të identifikohen sipas deklaratës nën betim.
2. Normativa aktuale (Rregullorja Nr.02/2020 për ndryshimin e Rregullores nr. 01/2017 për Taksa dhe gjoba) parasheh taksën e aplikimit dhe taksën dhe taksën për marrjen e autorizimit, andaj rekomandohet që taksa të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim. Kjo nënkupton implikimet në plotësim/ndryshimin e Rregullores së referuar.
3. Publikimi i njoftimit për marrjen e autorizimit të behët nga ARH në ueb faqe.

LICENCË E MAKINISTIT

1.Baza ligjore për lëshimin e licencës për makinist:

Neni 3 (1.32) i Ligjit për Hekurudhat Nr. 04/L-063 përcakton detyrat e makinistit ndër të tjera: personi i aftë dhe të autorizuar për të drejtuar trenat duke përfshirë lokomotivat manovruese, trenat punues, mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes apo trenat për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave në hekurudhë në mënyrë autonome, të përgjegjshme dhe të sigurt.

Baza konkrete ligjore për dhënien e këtij lejimi paraqitet në nenin 95 të Ligjit për Hekurudhat Nr. 04/L-063. Ky nen nje dhënien e autorizimeve si licenca e cila demonstroi se makinisti i plotëson minimumin e kushteve sa i përket kërkesave mjekësore, edukimit bazik dhe aftësive të përgjithshme profesionale. Në lidhje me kushtet për të marrë licencën, sipas nenit 96 të Ligjit Nr.04/L-063 aplikuari duhet të plotësojë minimumin e kërkesave të paraqitura në ligjin bazik, dhe se për të marrë certifikatë që ajo të mbetet e vlefshme, aplikuesit duhet të mbajnë licencë dhe të plotësojnë kërkesat minimale. Përveç kushteve/kritereve të potencuara, kërkohet Certifikata e Makinistit e lëshuar nga Ndërmarrja Hekurudhore, pastaj raporti mjekësor sipas rregullores për Licencimin e Makinistëve (Kontrolli Mjekësor).

Në lidhje me këtë aspekt flet pjesa hyrëse e nenit 95, si dhe neni 96 par. 3 (3.1 dhe 3.2) e cila dispozitë është transpozuar nga Direktiva e BE-së 2007/59. Për sa i përket aktit nënligjor që në mënyrë konkrete adreson fushën respektive, rregulloren nr.02/2013 për licencimin e makinistit, e cila në shumë dokumente vazhdimisht referohet si akt specifik, me gjithë përpjekjet dhe hulumtimet e bëra për gjetjen e saj, rregullorja përkatëse nuk figuron apo nuk është e qasshme në mënyrë elektronike. Në fakt versioni i cili ekziston në ueb faqen e ARH-së është Rregullorja Nr.01/2020 për ndryshimin e Rregullores Nr.02/2013, por që në rastin konkret nuk i përgjigjet kërkesave.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Qëllimi i licencimit të makinistëve është rregullimi dhe mbikëqyrja e sektorit hekurudhor komfor dispozitave ligjore në fuqi si dhe praktikave më të mira evropiane dhe rajonale. Veprimtaria përkatëse ka të bëjë me dhënien e një apo më shumë certifikata që identifikojnë infrastrukturën në të cilën mbajtësi i licencës është i autorizuar të vozis dhe të identifikojnë mjetet lëvizëse të cilat mbajtësi i licencës është i autorizuar ti drejtoj.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 96 (6.4) të Ligjit për Hekurudhat, licenca duhet të jetë e vlefshme për dhjetë (10) vite, por që i nënshtrohet kontrollimeve periodike, inspektimeve dhe monitorimit.

1.4.Taksa e nevojshme për pagesë

Pagesa për aplikim-pajisje për licencë është 50 euro, ndërsa për marrje të licencës është 200 euro .

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Licencë e re: 1. Aplikacioni I nënshkruar; [Origjinal]
2. Autorizimi për të proceduar të dhënat personale; [Origjinal]
3. Dëshmi për kualifikim; [Kopje e verifikuar]
4. Certifikate e përshtatshmërisë fizike; [Origjinal]
5. Certifikate e përshtatshmërisë psikologjike; [Origjinal]
6. Certifikate e njohurive të përgjithshme; [Origjinal]
7. Kopje të dokumentit identifikues; [Kopje]
2. Përditësim:Licencën ekzistuese [Origjinal]
2. Arsyeja për përditësim të licences; [Përshikim]
3. Amendamentim: 1. Licencën ekzistuese; [Origjinal]
2. Certifikate e përshtatshmërisë fizike; [Origjinal]
3. Arsyeja për ndryshim; [Përshikim]
4. Duplikim; 1. Deklarimi i arsyes pse kërkohet duplikim (shkatërruar/humbur/etj); [Përshikim]
5. Ripërtëritje: 1. Certifikate e përshtatshmërisë fizike; [Origjinal]
2. Kopje të licencës së fundit; [Kopje]
3. Dëshmi për mbetje kompetent (nëse kërkohet); [Origjinal]

1.2.Rekomandime:

1. Të azhurnohet ueb faqja e ARH-së dhe të vendoset Rregullorja për Licencimin e Makinistit, sepse në ueb faqen aktuale figuron vetëm Rregullorja Nr.01/2020 për Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2013 për Licencimin e Makinistit e cila nuk i përgjigjet nevojave dhe kërkesave në lidhje me hulumtimin.
2. Taksa të paguhet në rast të miratimit të kërkesës dhe nxjerrjes së vendimit për miratim e cila duhet të reflektohet me ndryshim plotësimin e Rregulores nr.02/2020 për Taksa dhe Gjoba.

LICENCË PËR MENAXHERIN DHE MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHOREN

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Baza ligjore e kësaj licence përfshihet në disa nene 10, 46, 92 dhe 93 të Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063, nga dhe në nenin 10 (par. 1) nga dhe përcaktohet që aplikimi i procedurave, vendimeve për dhënien e licencës dhe lëshimi i licencave do të jetë detyrë e organit licencues, ku ARH duhet të sigurojë që procesi i vendimmarrjes për dhënien e licencave të jetë i drejtë, transparent dhe jo diskriminues dhe që vendimet t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor.

Gjithashtu ligji bazik përmes nenit 3 (1.4) Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore e përcakton si njësi organizative që është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, duke përfshirë dhënien e trasesë së trenit dhe kërkimin e pagesës për atë shfrytëzim e gjithashtu edhe rregullimin e trafikut, funksionet e përmendura të menaxhimit të infrastrukturës i atribuohen më shumë se sa vetëm një njësi organizative.

Në kuptim të legjislacionit të aplikueshëm, rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga linjat hekurudhore nacionale ekzistuese dhe ato të ardhshme të Kosovës, të cilat ofrojnë qasje tek terminallet apo lokacionet e tjera specifike që iu shërbejnë një apo më shumë shfrytëzuesve të shërbimeve hekurudhore.

Për kushtet rreth fitimit të licencës referencë është neni 46 i Ligjit për hekurudhat (04/L-063), i cili liston kriteret që kryesisht orientohen tek ajo që selitë e entiteteve ligjore duhet të jenë në territorin e Kosovës, kompania të jetë e regjistruar për aktivitetin e menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore, që kompania të mos jetë në procedurë bankrotimi, dhe të jetë e aftë financiarisht që mund të plotësojë obligimet e veta të tanishme apo të ardhshme brenda afatit prej 12 muajsh. Për më tepër sipas dispozitës përkatëse, secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të aplikojë dhe të marrë autorizimin e sigurisë nga autoriteti nacional që është kompetent për sigurinë hekurudhore.

Në lidhje me licencimin e menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore, e cila adreson këtë pjesë është Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 plotësuar dhe ndryshuar me UA Nr. 18/2017. Me këtë udhëzim (administrativ) përcaktohen kriteret, procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencës për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve hekurudhore në Kosovë.

Udhëzimi përkatës përcakton llojet e licencave të cilat lëshohen për Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore: a) licencat për menaxhimin e rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhore, b) licencat për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave -stacione ranzhiuese (LicencS), c) licenca për mirëmbajtjen e depove hekurudhore dhe mjeteve tjera lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes (Licenca M), ç) Licencat për operime të kombinuara të rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhore për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) Licenca (O).

Për sa i përket procedurës për aplikim, udhëzimi vetëm e referon faktin se të gjitha format dhe dokumentet e tjera të nevojshme për dhënien e licencës për menaxher të infrastrukturës hekurudhore publikohen në ueb faqen e ARH-së, në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhën angleze, por jo se udhëzimi respektiv jep ndonjë përcaktim konkret rreth këtij aspekti. Përveç kësaj, ani që në hyrje të udhëzimit theksohet që ky udhëzim ka të bëjë me kriteret, procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencës, në fakt po të analizosh brendësinë (përmbajtjen) e tij, nuk gjene asnjë dispozitë konkrete që i referohen këtyre proceseve që duhet të ndiqen. Për më tepër as UA Nr. 18/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit bazik, nuk referon diçka specifike në lidhje me çështjet e ngritura.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Veprimtaria përkatëse ka të bëjë me rregullimin dhe zhvillimin e sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Për sa i përket vlefshmërisë, ligji bazik por edhe legjislacioni sekondar nuk flasin konkretisht rreth vlefshmërisë së kësaj licence. Megjithatë, duke pas parasysh se licencat tek ARH janë me afat të pacaktuar, konsideroj se edhe në rastin konkret licencat janë në standardin e njëjtë, siç edhe janë specifikuar në Ligjin bazik neni 92 dhe Rregulloren Për Licencat nr.03/2020 (neni 7).

1.4. Pagesa e taksës

Pagesa për pajisje për licencën përkatëse është 8000 euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e biznesit [Kopje e verifikuar]
- Polica e sigurimit [Kopje e verifikuar]
- Planin e biznesit tendërrmarjes [Kopje e verifikuar]
- Dëshmi për përshtatshmëri financiare [Kopje e verifikuar]
- Dëshmi për rreputacion të mirë dhe kompetencë të sigurisë [Kopje e verifikuar]

1. 2.Rekomandime:

1. Të plotësohet/ndryshohet udhëzimi administrativ, ose të nxjerrët një akt i ri nënligjor me të cilën përcaktohen kushtet, procedura dhe aspekte tjera relevante rreth kësaj licence;
2. Ani që në praktik aplikohet/zbatohet mundësia e ofrimit të plotësimin të dokumentacionit shtesë deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën, kjo çështje të përcaktohet në prizmin ligjor;
3. Taksa të paguhet me rastin e miratimit të aplikacionit.

4.AUTORIZIM I SIGURISË PËR MENAXHERIN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

1.Baza ligjore për lëshimin e Autorizimit të Sigurisë:

Baza ligjore e këtij autorizimi përcaktohet në Ligjin Nr.04/L-063 për Hekurudhat, neni 3 (1.8), ku saktësohet që Autorizimi i Sigurisë është dokumenti me të cilin menaxheri i infrastrukturës dëshmon se plotëson kushtet për ofrimin e shërbimeve infrastrukturore të sigurta. Certifikata e sigurisë mund të mbulojë tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës apo vetëm një pjesë të definuar të tij. Qëllimi i certifikatës së sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore e ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësojë kërkesat e paraqitura në specifikimet teknike të interoperabilitet (STI), legjislacionin tjetër të BE-së dhe rregullat nacionale të sigurisë për kontrollin e rrezikut dhe operimin e sigurisë në rrjet.

Në lidhje me autorizimet e sigurisë, Ligji bazik në nenin 104, i trajton në mënyrë të hollësishme të gjitha kushtet, kriteret dhe aspektet tjera relevante për fushën përkatëse. Në këtë prizëm, secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, duhet të marrë autorizimin e sigurisë. Më konkretisht, sipas legjislacionit të aplikueshëm, autorizimi i sigurisë duhet të përmbajë:

- përshkrimin që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të infrastrukturës, përshkrimin që konfirmon pranimin e dispozitave të menaxherit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn;
- mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë kur është e përshtatshme mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit;
- secila ndërmarrje hekurudhore duhet të pajiset me certifikatë (pjesën a dhe pjesën b) paras e t'i jepet qasja në infrastrukturën hekurudhore;
- të gjithë akterët e tregut të cilët janë pajisur me certifikata të sigurisë, autorizimet e sigurisë, autorizimet e sigurisë duhet të monitorojnë nëse ata i plotësojnë kërkesat e certifikatave të tyre dhe të marrin veprime korrektuese të domosdoshme, dhe se organi i ngarkuar (Organi i Sigurisë) duhet të jetë i lirë për të kryer inspektimet dhe hetimet e nevojshme, të cilat janë të nevojshme për të kryer detyrat e veta.

Më tutje ligji bazik (Ligji Hekurudhave), referon të gjitha llojet e autorizimeve të sigurisë, respektivisht kushteve për marrjen e tyre, duke filluar nga autorizimi për vendosjen e përbërësve të inoperabilitetit në treg (108), pastaj autorizimi për futjen nën shërbim të nënsistemeve strukturale në Kosovë (109), nga dhe përcaktohet që për të marrë një autorizim të tillë, duhet të plotësohen disa kushte, por si më kryesorët veçohen: që aplikuesi duhet të dëshmojë që nënsistemi është i dizajnuar, ndërtuar dhe instaluar në mënyrë ashtu që t'i plotësojë kërkesat themelore kur të integrohet në sistemin hekurudhor. Në veçanti aplikuesi duhet të dëshmojë kopatibilitetin teknik të nënsistemit me sistemin në të cilin është integruar; integrimin e sigurt të nënsistemit në sistemin hekurudhor; përputhshmërinë e nënsistemit me dispozitat e specifikimeve teknike për ndër operim mbi operimin dhe mirëmbajtjen. Në rrjedhën e autorizimeve tjera, ligji referon autorizimin për vendosjen e mjeteve të transportit në shërbim (neni 110), si dhe përputhshmëria e interoperabilitetit, autorizimet e sigurisë të menaxherëve të infrastrukturës dhe certifikatat e sigurisë të ndërmarrjeve hekurudhore.

Për zbatimin praktik të legjislacionit bazik, është nxjerrë Rregullorja Nr.03/2012 për Autorizim të Sigurisë, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 Për Dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2016, nga dhe janë përcaktuar llojet e autorizime të sigurisë në Kosovë, të cilat i lëshon ARH, si dhe Rregulloret nr.03/2012 dhe Nr.04/2017. Më saktësisht në nenin 3 të UA (Nr.04/2012) listohen llojet e autorizimeve, si në vijim:

1. Autorizimin e Sigurisë për funksionimin/operimin e rrjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës hekurudhore (Autorizimi i Sigurisë A);
2. Autorizimin e Sigurisë për stacione hekurudhore dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacione ranzhiruese) (Autorizimi i Sigurisë B)
3. Autorizimin e Sigurisë për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjetet tjera të mirëmbajtjes (Autorizimi i Sigurisë C)

4. Autorizimin e Sigurisë për operacione të kombinuara të rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore, stacione hekurudhore dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Autorizim i Sigurisë D).

Për sa i përket autorizimeve evropiane të sigurisë, pranohet Autorizimi i Sigurisë, pjesa A i lëshuar nga një Organ i Sigurisë të Bashkimit Evropian (BE), nënshkrues të marrëveshjes së Komunitetit të Transporteve dhe Organeve tjera të huaja të Sigurisë, nëse ato përputhen me legjislacionin e Kosovës.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet autorizimi i sigurisë:

Dokumenti me të cilin menaxheri i infrastrukturës dëshmon se plotëson kushtet për ofrimin e shërbimeve infrastrukturore të sigurta. Ky autorizim i sigurisë sipas emërimit nënkupton që secili menaxher i infrastrukturës hekurudhore duhet të pajiset me autorizimin e sigurisë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

1.3 Vlefshmëria kohore e autorizimit të sigurisë:

Për sa i përket vlefshmërisë, nuk specifikohet konkretisht afati, por që edhe në rastin konkret merren parasysh rregullat e përcaktuara, që vlejnë përshtatshmërisht për licencat/autorizimet tjera, sikurse në Ligjin bazik (neni 92) dhe në Rregulloren nr. 3/2020, neni 7, nga dhe specifikohet që licencat janë me afat të pacaktuar. Ndërsa sa i përket rishqyrtimit, sipas nenit 46 (3) të Ligjit Nr.04/L063, ajo bëhet në afat kohor që nuk kalon 5 vite.

1.4. Pagesa e taksës

Sipas Rregullores Nr. 02-2020 për Plotësim/Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2017 për Taksa dhe Gjoha aplikohet Taksa për Aplikim 250 euro, Taksa për marrje të Autorizimit të Sigurisë 6000 euro dhe Taksa për Renovim të Autorizimit të Sigurisë 1000 euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e biznesit [Kopje e verifikuar]
- Licencë për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore [Kopje e verifikuar]
- Deklarata e konformitetit [Kopje e verifikuar]
- Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë [Kopje e verifikuar]
- Pjesa A
- Përmbledhje e sistemit të menaxhimit të Sigurisë (përfshirë edhe Deklaratat e Konformitetit)
- Pjesa B
- Kopja e pjesës A të Autorizimit
- Lista kontrolluese nacionale e aplikimit për autorizim të sigurisë
- Përshkrim i detajuar i rrjetit (lista e seksioneve të linjave, pozitës gjeografike)
- Lista e ndërlidhjeve me linjat e tjera hekurudhore/MI
- Lista e rregulloreve përkatëse duke përfshirë TSI-në, rregulloret e shpallura rreth sigurisë kombëtare, rregulloret rreth interoperabilitetit, rregulloret e tjera publike, kushtet e qasjes në rrjet, rregulloret e tjera të brendshme.

Rekomandime

1. Ani që në praktik aplikohet/zbatohet mundësia e ofrimit të plotësimit të dokumentacionit shtesë deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën, kjo çështje të përcaktohet në prizmin ligjor;
2. Taksa të paguhet me rastin e miratimit të aplikimit e cila duhet të reflektohet me plotësim/ndryshimin e rregullores nr. 02/2020 për taksa dhe gjoba.

LICENCË PËR TRANSPORT HEKURUDHOR PËR MALLRA DHE UDHËTAR

1.Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Baza ligjore e kësaj licence përcaktohet vetëm në kuptimin e përgjithshëm në nenin 92 të Ligjit për Hekurudhat, nga dhe përcaktohet që ndërmarrja hekurudhore (që nënkupton ndërmarrjen private apo publike), biznesi kryesor i së cilës është të ofroj shërbime të transportit hekurudhor për udhëtarët dhe mallrat me kërkesën që ndërmarrja aplikuese të siguroj tërheqjen e trenave, nuk mund t'i ofrojë këto shërbime pa qenë e licencuar. Në këtë drejtim sipas ligjit bazik licenca duhet të specifikoj llojet e shërbimeve hekurudhore për të cilat pronarit i është dhënë licenca.

Nga një vështrim i hollësishëm i ligjit për hekurudhat, respektivisht dispozitës ligjore të referuar (neni 92), e cila orienton se me cilat lloje të shërbimeve ofron dhe se ato (shërbime) nuk mund të ofrohen pa qenë e fituar licenca, duhet sqaruar që pjesa vijuese adreson jo vetëm licencën në lidhje me licencën respektive (licencën për transport hekurudhor për mallra dhe udhëtar), por edhe ato në aspektin e përgjithshëm. Më tutje ligji bazik adreson faktin që domosdoshmërisht ndërmarrja aplikuese para se të filloj me aktivitetet e veta duhet të jetë në gjendje të demonstroj tek autoriteti licencues i Kosovës, se ai në çdo kohë është në gjendje të plotësoj kërkesat që kanë të bëjnë me mallrat, përshtatshmërinë financiare, kompetencën profesionale dhe të ketë mbulesë për përgjegjësinë e tij civile.

Në këtë drejtim secila ndërmarrje e cila aplikon (për licencë) duhet të ofrojë gjithë dokumentacionin relevant e cila i përgjigjet kushteve (kriterëve) për tu plotësuar - siguruar nga ndërmarrja aplikuese, të cilat kryesisht orientohen në disa segmente, duke filluar nga reputacioni i mirë, që bazë ka disa aspekte, se nuk janë të dënuar për vepër penale, duke përfshirë kundërvajtjet e natyrës komerciale, që nuk janë të deklaruar të bankrotuar, nuk janë dënuar për kundërvajtje ndaj legjislacionit specifik të aplikueshëm në transport, nuk janë dënuar për dështim serioz apo të përsëritur për plotësimin e obligimeve të ligjit social apo atij të punës duke përfshirë obligimet për sigurinë profesionale dhe legjislacionin e shëndetit.

Kriter tjetër (sikurse në licencat tjera), ka të bëjë apo ndërlidhet me anën financiare, nga dhe kërkesat që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë financiare duhet të plotësohen kur ndërmarrja aplikuese mund të demonstroj se do të jetë në gjendje të plotësoj obligimet e tanishme dhe potenciale të vendosura mbi supozimin real për një kohë prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Në këtë aspekt secila ndërmarrje aplikuese duhet të paraqes të paktën llogarinë e vet vjetore apo në rast kur ndërmarrja aplikuese nuk është në gjendje të paraqes llogarinë vjetore, atëherë të paraqet bilancin e saj. Të veçantat e detajuara duhet të ofrohen në veçanti të dhënat vijuese: fondet në dispozicion duke përfshirë bilancin bankar, tërheqje e mëdha të parave dhe kreditë, fondet dhe asetet në dispozicion për siguri, kapitali i punës, kostot relevante, duke përfshirë

koston për blerjen e mjeteve të transportit, tokës, ndërtesave, instalimeve dhe mjetet lëvizëse, pagesat për a setet e ndërmarrjes.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i cili kërkohet të plotësohet gjatë procesit të aplikimit ka të bëjë me natyrën e sigurisë, ku ndërmarrja aplikuese duhet të prezantoj të dhënat që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, në veçanti sa i përket standardeve të sigurisë, të dhënat për kualifikimet e personit përgjegjës për siguri si dhe detajet për trajnimin e personelit.

Përveç tjerash, ndërmarrja aplikuese duhet të jetë e siguruar në mënyrë adekuate apo në përputhje me ligjet nacionale dhe ndërkombëtare të bëjë aranzhime ekuivalente për të mbuluar përgjegjësitë e vet në rast të aksidenteve e në veçanti me udhëtarët, bagazhin, mallrat, postën dhe palët e treta. Po ashtu duhet theksuar se kjo pjesë në mënyrë të hollësishme trajtohet përmes Udhëzimit Administrativ Nr.02/2012 Për Licencimet e Operatorëve të Transportit Hekurudhor.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Kjo licencë aplikohet për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore (publike apo private), për transportin e udhëtareve dhe mallrave. Si objektiv parësor është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Aspekti legjislativ pjesën përkatëse (vlefshmërinë) nuk e trajton në mënyrë specifike, megjithatë edhe në lidhje me këtë licencë, kemi të bëjmë me afat të pacaktuar, si referencë gjeneralë e dhënë në kuadër të nenit 92 të ligjit bazik (Ligji për Hekurudhat).

1.4. Pagesa e taksës

Pagesa për aplikim është 250 euro ndërsa pagesa për licencë është 5000 euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Certifikata e biznesit [Kopje e verifikuar]
2. Polica e sigurimit [Kopje e verifikuar]
3. Planin e biznesit të ndërmarrjes [Kopje e verifikuar]
4. Dëshmicpërcpërshtatshmëri financiare [Kopje e verifikuar]
5. Dëshmi për reputacion të mirë dhe kompetencë të sigurisë [Kopje e verifikuar]

2.Rekomandime:

1. Mundësia që pala të ofrojë dëshmi shtesë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për licencën në kuptimin praktik është e zbatueshme dhe kjo duhet të harmonizohet në prizmin ligjor;
2. Taksa e aplikimit të paguhet me rastin e miratimit të aplikacionit e cila reflekton ndryshimet në legjislacionin sekondar përkatësisht rregulloren nr.02/2020 për Gjoba dhe Taksat.

CERTIFIKATA E SIGURISË PËR NDËRMARRJET HEKURUDHORE

1.Baza ligjore për lëshimin e Certifikatës së Sigurisë:

Baza ligjore e kësaj licence përcaktohet në Ligjin për Hekurudhat Nr.04/L-063 nenin 3 (1.7), ku saktësohet që Certifikata e Sigurisë është dokumenti me anë të së cilit ndërmarrja hekurudhore dëshmon se i përmbush kushtet për trafik të sigurt në linja specifike hekurudhore apo në tërë rrjetet hekurudhore.

Në mënyrë që t'i jepet qasje në infrastrukturën hekurudhore, sipas nenit 94 (1) ndërmarrja (hekurudhore) e cila është e licencuar duhet të ketë certifikatën e sigurisë e cila mund të mbulojë tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës apo vetëm një pjesë të definuar të tij. Certifikata e sigurisë përmban përshkrimin i cili konfirmon pranimin e sistemit menaxhues të sigurisë së ndërmarrjes hekurudhore. Më konkretisht ofrimi i pjesës së parë të certifikatës ka të bëjë me përshkrimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë që duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante. Në lidhje me këtë, sipas dispozitës përkatëse elementet themelore të sistemit të menaxhimit të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore janë:

- politika e sigurisë e miratuar nga kryeshefi ekzekutiv i organizatës dhe që i komunikohet tërë stafit;
- qëllimet kualitative dhe kuantitative të organizatës për mirëmbajtje dhe rritje të sigurisë si dhe planet dhe procedurat për ti arritur ato qëllime;
- procedurat për plotësimin e standardeve teknike operacionale ekzistuese, të reja dhe të ndryshuara, për të siguruar përputhje me standardet dhe kushtet e tjera të pajisjes dhe operimeve;
- procedurat dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të rrezikut dhe zbatimin e masave të kontrollit të rrezikut kurdo që ka ndryshim në kushtet e operimit;
- ofrimi i programeve për trajnim të stafit dhe sistemeve për të siguruar që kompetenca e stafit mbahet në nivel dhe detyrat kryhen në mënyrë profesionale;
- procedurat për të siguruar se aksidentet, incidentet, aksidentet e rënda dhe ngjarjet e tjera të rrezikshme të raportohen, hetohen, analizohen dhe merren masa të domosdoshme preventive;
- ofrimi i planeve për veprim, alarmimet dhe informacioni në rast të emergjencës në pajtim me autoritetet e duhura publike;
- përshkrimi i cili konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara nga ndërmarrja hekurudhore për plotësimin e kërkesave specifike të domosdoshme për operim të sigurt të rrjetit relevant;
- si dhe një numër tjetër i kriterëve të listuara/specifikuar në dispozitën përkatëse.

Për sa i përket certifikatës së sigurisë A së dhënë nga ndërmarrjet hekurudhore të vendosura në BE nga organi i ngarkuar për siguri hekurudhore në një vend anëtar të BE-së, duhet të konsiderohet valide në Kosovë, nëse ende është valide në BE dhe nëse është në përputhshmëri me legjislacionin e Kosovës.

Në lidhje me përtëritjen e certifikatës së sigurisë, ajo duhet të përtërihet pas aplikimit nga ndërmarrja hekurudhore në intervale që nuk i tejkalojnë pesë (5) vite, e cila përtëritet plotësisht apo pjesërisht, kurdo që lloji apo shtrirja e operimit është ndryshuar substancialisht, dhe për këtë duhet të informohet ministria e linjës, përgjegjëse e fushës.

Po ashtu edhe në korpusin e legjislacionit sekondar trajtohet certifikimi i sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore, përmes Udhëzimit Administrativ Nr.04/2012 ndryshuar dhe plotësuar me UA Nr.02/2016, Rregullores nr.02/2012, Rregullores nr. 02/2018 dhe Rregullorja nr.06/2018. Duke pas parasysh faktin se tek ligji bazik janë trajtuar në detaje kushtet/kriteret për këtë lloj certifikimi, nga udhëzimi administrativ mund të shkoqisim vetëm segmente të caktuara, të cilat kryesisht referojnë faktin (ngjashëm me principet e ligjit bazik) se ARH duhet ti trajtojë kërkesat respektive në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese dhe në afatin kohor prej më së shumti 120 ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet certifikata e sigurisë:

Qëllimi i certifikatës së sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore e ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në specifikimet teknike të interoperabilitetit (STI) legjislationin tjetër të BE-së dhe rregullat nacionale të sigurisë për kontrollon e rrezikut dhe operimin e sigurt në rrjet.

1.3 Vlefshmëria kohore e Certifikatës së Sigurisë:

Në parim, sikurse tek kategoritë tjera që licencat/autorizimet lëshohen në afat të pacaktuar, e njëjta rregull vlen edhe te ky lloj certifikim. Megjithatë, përtërija e tyre specifikohet në Ligjin për Hekurudhat nr.04/L-063, Neni 94, paragrafi 8, ku theksohet që ajo duhet të bëhet çdo 5 vite.

1.4. Pagesa e taksës

Sipas Rregullores Nr.02-2020 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.01-2017 për Taksa dhe Gjopa aplikohet taksat si në vijim: Taksa për Aplikim 250 euro, Taksa për Marrje të Certifikatës së Sigurisë 4.000 euro, ndërsa Taksa për rinovim të Certifikatës së Sigurisë 1.000 euro.

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e biznesit; [Kopje e verifikuar]
- Licencë për Transport Hekurudhor për Mallra dhe Udhëtar; [Kopje e verifikuar]
- Deklarata e konformitetit; [Kopje e verifikuar]
- Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë; [Kopje e verifikuar]
- Pjesa A
- Përmbledhje e manualit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë siç referohet në nenin 9 dhe shtesës së direktivës 2004/49/KE (përfshirë Deklaratën e Konformitetit).
- Kopja e licensës
- Pjesa B
- Kopja e certifikatës pjesa – A
- Kopja e sigurimit ose mbulesës financiare për përgjegjësi, shtesa e licensës
- Lista e rregullave të domosdoshme dhe STI-së (TSI) duke ju referuar procesit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë dhe dokumenteve se si ato janë implementuar.
- Lista e kategorive të ndryshme të personelit, të punësuar ose kontraktuar.
- Përshkrimi i personelit lidhur me procesin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, të kërkuar sipas rregullave nacionale ose STI (TSI) dhe referimi në certifikatat nacionale kur është e nevojshme.
- Lista e llojeve të ndryshme të mjeteve lëvizëse.
- Përshkrimi i mjeteve lëvizëse lidhur me procesin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, të kërkuar sipas rregullave nacionale ose STI-së (TSI) dhe referimi në certifikatat nacionale kur është e nevojshme.